



UNIVERSITETI I GJAKOVËS  
"FEHMI AGANI"  
UNIVERSITY OF GJAKOVA

Rr. Ismail Qemali, pn 50 000 GJAKOVË, Republika e Kosovës  
Tel: 038 200 20 831; www.uni-gjk.org

Kryesuesi i Këshillit Drejtues  
Prof. Asoc. Dr. Mazllom Kumnova

Nr.Prot.: 05/579  
Datë 22/05/2020

Këshilli i Drejtues i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", bazuar në nenin 17. pika 3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", në mbledhjen e mbajtur më 22.05.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet kërkesa e Prof. Ass. Dr. Vjollca Dibra, Prorektore për çështje akademike dhe cilësi në UGJFA, për mbështetje financiare të përkthimit dhe botimit të librit me titull: "Heroinat e deheroizuara", libër studimor mbi letërsinë krahasimtare të autorëve Kadare – Boll.
- II. Libri nga pika I e këtij vendimi do të botohet si publikim i veçantë dhe do të përmbajë: emrin, logon dhe ISBN-ën e Universitetit të Gjakovës, në pajtim me vendimin e Senatit të Universitetit nr. 04/575 të datës 22.05.2020.
- III. Universiteti i Gjakovës do të mbështesë financiarisht 70% të kostos së faturës së përkthimit dhe botimit të librit nga pika I e këtij vendimi, përkatësisht me shumën prej: 1,675.33 euro.
- IV. Financimi i përkthimit dhe botimit bëhet nga mjetet e buxhetit të UGJFA- së, nga kategoria e subvencioneve dhe transferove për vitin 2020.
- V. Pas botimit të librit nga pika I e këtij vendimi Universiteti i Gjakovës obligohet t'i dorëzojë autores 50 kopje të librit kurse kopjet tjera i mbesin Universitetit të Gjakovës.
- VI. Zyra e financave e UGJFA-së është i obliguar të bëjë zbatimin e këtij vendimi në bazë të dëshmive dhe faturave përkatëse.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i Universitetit të Gjakovës, pasi shqyrtoi kërkesën me nr.05/557 dt. 21.05.2020, të Prof. Ass. Dr. Vjollca Dibra, Prorektore për çështje akademike dhe cilësi në UGJFA, për mbështetje financiare të përkthimit dhe botimit të librit me titull: "Heroinat e deheroizuara", për të cilën publikim Senati ka lejuar përdorimin e emrit, logos dhe ISBN-së së UGJFA-së, e konsideroi të arsyeshme kërkesën, duke pasur parasysh se ky libër do të jetë pronë e Universitetit dhe do të përdoret nga studentët, si dhe për arsye se Universiteti i Gjakovës mbështet botimin e publikimeve të veçanta të karakterit profesional, shkencor, letrar dhe artistik. Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendimi t'i dërgohet:

1. Prof.Ass.Dr. Vjollca Dibra;
2. Menaxhmentit të UGJFA-së;
3. Zyrës së financave të UGJFA-së;
4. Arkivit të UGJFA-së.



Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Prof. Asoc. Dr. Mazllom Kumnova